REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 449/26 Dt. 22.09.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Vendimit 001-011 nr. 38220, të datës 30.03.2026 të Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR PAGESË TË TARIFËS SË VARRIMIT DHE PAGESËS SË KONTRIBUTIT VJETOR

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për pagesë të tarifës së varrimit dhe mirëmbajtjes dhe pagesës së kontributit vjetor të Komunës së Prizrenit, kështu që, për:

   1.1. Tarifën e shërbimit bazë të varrimit dhe mirëmbajtjes, lejohen mjetet financiare në shumën prej 394,00 € (treqind e nëntëdhjetë e katër euro) për 1 (një) varr dhe,

   1.2. Kontributin vjetor të Komunës së Prizrenit, lejohen mjetet financiare në shumën prej 65,300.00 € (gjashtëdhjetë e pesëmijë e treqind euro).

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Vendimi 001-011 nr. 38220, të datës 30.03.2026, të Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.